

FJALA E DEPUTETIT FATMIR MEDIU

E ENJTE 10 SHKURT 2022

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa dyshim që pas kësaj eksperience politike dhe parlamentare, çfarë më shqetëson është fakti sa lehtësisht diskutojmë ne për ndryshimet e Kushtetutës. E kemi katandisur Kushtetutën në një letër pa vlerë, një gjë e cila nuk ka të bëjë thjesht me ne, por ka të bëjë me qytetarët në radhë të parë. Momentet e ndryshimeve kushtetuese janë momente shumë të veçanta përgjegjësie për çdo deputet, të cilat duhet të paraprihen nga një diskutim i gjerë jo vetëm ndërmjet përfaqësive politike, por, pa diskutim, të ekspertëve. Për të bërë një analizë për çdo problem pse duhet ky ndryshim kushtetues, duhet të përfshijmë edhe një analizë të qartë përse jemi në këtë situatë. E para, sa dhe si komisionet e vetingut e kanë respektuar me integritet ligjin, sepse kemi dëgjuar edhe sot pretendime, akuza?

E dyta, sa akuzat dhe pretendimet e palëve politike për këtë proces, kërkesat dhe pretendimet e partnerëve tanë ndërkombëtarë, edhe të vetë ONM-së, duhet të vlerësohen? E treta, me problemet që ka sot gjyqësori, prokuroria, me mangësitë pa fund që kanë, me burimet e tyre njerëzore për ta dhënë drejtësinë në kohë, sa mundësi ka sot Shkolla e Magjistraturës për të plotësuar vendet vakante që të kemi një gjyqësor dhe një drejtësi funksionale? A duhet që riorganizimi i gjyqësorit të nisët vetëm nga parimi dhe fakti se sa gjyqtarë kemi, apo të kemi një riorganizim gjyqësor që të jetë pranë qytetarëve dhe t'u japë mundësi atyre për të gjetur të drejtën e tyre? Në Komisionin e Ligjeve, të nderuar kolegë deputetë, nga raportimi i zëvendësprokurorit të Përgjithshëm, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe drejtorit të Shkollës së Magjistraturës dukej se problemet në sistemin e drejtësisë janë më të thella sesa këto që diskutojmë ne sot. Dua të them që në krye të herës, duke dëgjuar të gjitha aludimet që bëhen nga palët, se kam qenë anëtar i Komisionit të Reformës në Drejtësi, me gjithë propagandën e madhe të gënjeshtërt që bëhet se opozita ka qenë kundër reformës në drejtësi, po ju them juve, kolegëve të së majtës, që pa opozitën kjo reformë në drejtësi nuk do të ishte bërë, ato ndryshime kushtetuese nuk do të ishin bërë. Por e bëmë atë votim dhe këtë reformë në marrëveshje me njëri-tjetrin për 7 ligjet organike, edhe për aktet e tjera ligjore, që të punojmë të gjithë së bashku. Ishte vota e opozitës ajo që bëri të mundur ndryshimin e Kushtetutës dhe krijimin e premisave për një reformë të drejtë në sistemin e drejtësisë. Por pas kësaj, maxhoranca veprroi në mënyrë të njëanshme, me qëllimet dhe interesat e saj politike për të kontrolluar sistemin e drejtësisë dhe miratoi pa opozitën ndryshimet ligjore.

Unë mendoj që duhet të shikojmë edhe te vetja jonë. A mjafton vetëm fakti të themi se çfarë ka bërë maxhoranca, apo si kemi vepruar edhe ne si opozitë? Personalisht mendoj se në çdo veprim, të qëllimshëm apo të paqëllimshëm, të interesave politike të maxhorancës për të kontrolluar drejtësinë, duhet të kishte dhe ka nevojë për një opozitë që të qëndrojë bashkë dhe të ketë një qëndrim dhe analizë të prerë për problemet e drejtësisë. Duhet me analizë dhe fakte të qarta të ballafaqohemi me partnerët tanë, duke treguar qartë se alternativa jonë nuk është bllokimi i procesit, nuk është moszgjatja e vetingut, por analiza e thellë për të pasur një proces vetingu të ligjshëm dhe transparent. Ne duhet të kishim përcjellë propozimet tona në kohë me njerëzit tanë, kur u kërkua të bëhej procesi i vetingut dhe të mos rrinim indiferent apo të thoshim se nuk hyjmë në procesin e vetingut dhe, pastaj, fatkeqësisht, të shkonim dhe të votonim kandidaturat e propozuara nga Partia Socialiste. Çfarë presim ne rezultat tjetër politikisht?! Këtë që ka ndodhur. Partnerët tanë ndërkombëtarë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, BE-ja, OSBE-ja, Gjermania, Britania kërkojnë të votojmë ndryshimet kushtetuese. Pa

dyshim që ka një rëndësi të jashtëzakonshme për gjithsecilin nga ne gjykimi, mendimi dhe kontributi i tyre. Për 30 vjet na kanë treguar që marrëdhënia e drejtë me ta na ka çuar përpara. Kur u përfshimë në proces, në këtë reformë, pranuar, të paktën ne si opozitë, unë si dëshmitar i reformës në drejtësi, se garancia më e madhe që kishim ishte pikërisht prezenca dhe angazhimi i tyre në këtë proces, në mënyrë të veçantë e ONM-së dhe ata sot janë të interesuar që të vazhdojë ky proces me prezencën dhe rolin e ONM-së. Ne duhet ta vlerësojmë që prezenca e tyre është domosdoshmëri ose, të paktën, na jep ne si opozitë një shans dhe mundësi të jemi pjesë e diskutimit të këtij procesi dhe të mos e lëmë peng të vetëm një kahu politik për të pasur si rezultat një drejtësi të politizuar.

Prandaj mendoj se opozita, së pari, duhet të komunikojë qartë me partnerët tanë për të ballafaquar shqetësimet rast pas rasti. Së dyti, vlerësojmë jo vetëm se si mundet të përfundojë ky proces vetingut, por sa me integritet janë komisionerët, e sa të drejtë dhe sa të barabartë përpara ligjit janë të gjithë ata që vetohen, sepse kanë qenë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, BE-ja dhe vetë ONM-ja që kanë ngritur raste të shqetësimeve të këtij procesi, kanë qenë ata të cilët kanë kundërshtuar edhe vendime të komisioneve të vetingut. Po ashtu, ka pasur edhe raste denoncimesh politike dhe publike. Këto shqetësime apo probleme duhet që ne, të nderuar kolegë opozitarë, t'i kishim bërë pjesë të debateve dhe të shqetësimit tonë në Këshillin e Legjislacionit, jo të vinim sot përballë faktit të kryer se çfarë do të bëjmë, do të votojmë apo jo. Asnjëherë bojkotimi i proceseve nuk na ka çuar në një zgjidhje të drejtë. E kundërta ka ndodhur. Pra, duhej që në këtë Këshill ne të diskutonim si ka funksionuar, cilat kanë qenë problemet, a duhej të shtonim vetues të tjerë, a duhej t'i ndryshonim vetuesit, përpara se të marrim thjesht një qëndrim politik lidhur edhe me interesa të tjera. Pa dyshim, në bindjen time personale, është që ky proces duhet të mbarojë dhe duhet një standard i barabartë për të gjithë ata që janë vetuar dhe do të votohen nëpërmjet këtyre komisioneve, por edhe sidomos me prezencën dhe mbështetjen e partnerëve tanë ndërkombëtarë. Kam ngritur një shqetësim në Këshillin e Legjislacionit dhe po e përsëris këtu: ka katër iniciativa për ndryshime kushtetuese në këtë Kuvend.

Mund të duket normale nga një pikëpamje, Kuvendi me 94 vota mund të ndryshojë Kushtetutën. Po i japim vetes një të drejtë që nuk e kemi. Po shkatërrojmë themelet e këtij shteti, nga një republikë kushtetuese e kemi kthyer në një republikë kryeministore; nga një parlament të qytetarëve, e kemi kthyer në parlament të qeverisë! Këtu ka gjithmonë një tragjikomedi që luhet, ku pjesën më të madhe të kohës e merr Kryeministri, qeveria, kurse ne, deputetët, jemi thjesht vëzhgues në shtëpinë tonë. Ne nuk kemi forcën, autoritetin për të ndikuar, jo për kontrollin e qeverisë, por as për të komunikuar me njëri-tjetrin për të bërë atë që duhet në shërbim të njerëzve që na kanë zgjedhur. Prandaj është e rëndësishme, të nderuar kolegë deputetë, të fillojmë të mendojmë realisht se çfarë duhet të bëjmë. Marrëzja e këtij Kuvendi duhet të marrë fund. Ne kemi nevojë për një reformë të thellë kushtetuese. Kemi nevojë për një Kushtetutë, e cila garanton një republikë parlamentare kushtetuese, ku parimi check and balance, pavarësia dhe kontrolli i pushteteve duhet të jenë bazat për garantimin jo vetëm të funksionimit të institucioneve, por edhe për garantimin e lirive dhe të drejtave të qytetarëve, të cilëve u mohohet çdo ditë, u nëpërkëmbet çdo ditë e drejta e pronës, e drejta e votës. Këto janë thelbësore që duhet t'i ngremë ne, si opozitë, si alternativë në bashkëpunim edhe me partnerët tanë. Pa dyshim, reforma zgjedhore, në radhë të parë, duhet për t'u dhënë shqiptarëve mundësinë të ndërtojnë me votë Kuvendin që të përfaqësojë interesat e tyre dhe jo vota e manipuluar. Një reformë administrative, në mënyrë të padiskutueshme, duhet sepse pushteti lokal është i qytetarëve dhe jo i kryetarëve të bashkive. Pushteti duhet ndier dhe të ushtrohet nga qytetarët. Kjo është vlere e pushtetit lokal. Pra, duke e mbyllur fjalën time, dua të them që, pa dyshim, dilema më e madhe është ndryshimi kushtetues, në bindjen time si politikan dhe si deputet, por nisur nga i gjithë interesi që ne kemi për ta përfunduar këtë reformë në drejtësi, më tepër sesa të ndahemi në pozicione politike, le të shikojmë të përfundojë ky proces, nëpërmjet vetingut dhe nëpërmjet asistencës së partnerëve tanë ndërkombëtarë. Nuk duhet vënë vetja përballë dhe kundër asaj pjese që ka ndihmuar dhe asistuar

gjatë gjithë kohës Shqipërinë, qoftë edhe reformën në drejtësi, pavarësisht nga problemet e thella dhe të drejta që u ngritën këtu për sa i përket kësaj reforme. Faleminderit!